REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 80/17
Datë/Datum. 27.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. nr. 80/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE ankues "ER-LIS Sh.p.k & VE-MOR Sh.p.k" - Pejë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Pejës" Lot 1, me nr prok: "635/16/113/221", i iniciuar nga autoriteti kontraktues /Komuna e Pejës/, më datën 18. 04. 2017, mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet** pjesërisht si e bazuar ankesa e OE "ER-LIS Sh.p.k & VE-MOR Sh.p.k" - Pejë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Pejës" Lot 1, me nr prok: "635/16/113/221", i iniciuar nga autoriteti kontraktues / Komuna e Pejës /.

II. **Anulohet,** vendimi për dhënie të kontratës i AK-së /Komuna e Pejës/, lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Pejës" Lot 1, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh, duhet ta informojë me shkrim Panelin shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe palët tjera në procedurë.

IV. Operatorit ekonomik ankues OE "ER-LIS Sh.p.k & VE-MOR Sh.p.k" - Pejë, i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, pasi që ankesa i është aprovuar si pjesërisht e bazuar.

V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të

sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me datën: 05. 12. 2016.

Hapja e ofertave është bërë me datën: 15. 12. 2016, ku kanë marr pjesë gjashtë (6) operatorë ekonomik.

Rivlerësimi i ofertave përsëri është bërë me datën 01.03.2017.

Letra standarde për tenderuesin e pasuksesshëm "ER-LIS Sh.p.k & VE-MOR Sh.p.k" - Pejë është bërë me datën: 02. 03. 2017.

Njoftimi për dhënie të kontratës është bërë me datën: 02.03.2017, e ku është rekomanduar për kontratë konsorciumi "Doreärti & Graniti & Lindi Markings"-Pejë.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës, operatori ekonomik "ER-LIS Sh.p.k & VE-MOR Sh.p.k" - Pejë, me datën: 07. 03. 2017, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me datën: 09.03.2017, autoriteti kontraktues ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik "ER-LIS Sh.p.k & VE-MOR Sh.p.k" – Pejë.

Operatori ekonomik "ER-LIS Sh.p.k & VE-MOR Sh.p.k" - Pejë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më datën 20 Mars 2017 me nr. 80/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Pejës" Lot 1, duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 7 i LPP-së –Barazia në trajtim jo diskriminim
- Neni 24 i LPP-së – Zyrtarët e prokurimit gjatë ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit
- Neni 59 i LPP-së –Ekzaminimi, vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 69 i LPP-së –Aftësia teknike dhe profesionale
- Neni 131 i LPP-së – Shkelja e Ligjit nga autoriteti kontraktues
- Neni 7.3 dhe 7.4 i Rregullave të udhëzuesit Operativ për prokurim publik
- Neni 24 paragrafi C i udhëzuesit operativ për prokurim publik - Grupi i operatorëve ekonomik

- Neni 24 paragrafi 1 pika C Rregullat e UOPP- Grupi i operatorëve Ekonomik
- Neni 41 i Rregullat dhe UOPP-A01 –vlerësimi dhe ekzaminimi i tenderëve

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertën e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese përmes raportit të datës 05 prill 2017, ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues "Komuna e Pejës" Lot 1 me nr.prok: 635/16/113/221 nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së. Andaj ekspertja shqyrtuese duka pasur parasysh konstatimin nr 3 dhe nr 7 në ekspertizë, i ka propozuar panelit shqyrtues që ankesën e operatorit ekonomik ankues të aprovojë si pjesërisht të bazuar, ndërsa të anuloj vendimin – njoftimin për dhënie të kontratës të autoritetit kontraktues dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datën: 06 prill 2017, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertes shqyrtuese.

Operatori ekonomik ankues "ER-LIS Sh.p.k & VE-MOR Sh.p.k" - Pejë, me datën: 11 prill 2017, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertes shqyrtuese.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 18.04.2017, kanë qenë prezent anëtarët e panelit shqyrtues, ekspertja shqyrtuese, përfaqësuesit e palëve në procedurë, vëzhgues nga OJQ "D Plus" ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik ankues "Er-Lis&Ve-Mor" ka deklaruar: "Desha të shtoj se po ashtu pretendim ankimorë ka qenë neni 10 për mos lejim të qasjes. Qëndrojmë në tërësi pranë pretendimeve ankimore dhe pajtohemi pjesërisht me mendimin e ekspertit. Nuk pajtohemi me ekspertin pasi mënyra e arsyetimit të veprimeve të AK-së është jo e drejtë dhe në kundërshtim me nenin 72.3 të LPP-së, kundër vendimit PSH.06/17, dhe në kundërshtim me interpretimin e KRPP të datës 14.04.2017. Sipas arsyetimit të ekspertit AK në pajtim me nenin 72 ka kërkuar nga OE sqarime shtesë lidhur me këto çështje : 1.caktimin e liderit në deklaratën e bashkëpunimit të këtij grupi të OE-ve. 2.të precizohet lista shërbimeve të kryera (origjinal) e mbështetur me referenca ose procesverbale. 3. të përcaktohet lista pajisjeve për realizimin e punëve në këtë lot. Në vendimin Psh.nr.06/17 për pikën 1.dekalrat konzorciumit thuhet "bazuar në dokumentet e lartpërmendura shihet se mungon deklarata e anëtarëve të grupit për të autorizuar partnerin udhëheqës që të veproj në emër të grupit në kundërshtim me nenin 27.1 pika.C". Eksperti e arsyeton dhe sqaron se pas kërkesës së AK-së OE e ka sjell vendimin për

caktimin e liderit. Si është e mundur që sqarim shtesë të jetë një vendim që nuk ka ekzistuar. Për pikën 2, kërkesa nenit 9.2 të FDT (dëshmitë e dokumentare), është kërkuar 1.lsita shërbimeve të ngjashme e vërtetuar nga OE origjinal. Kjo listë nuk është dorëzua fare sipas kërkesave por eksperti prape r arsyeton AK-në dhe sjelljen e listës të projekteve nga anëtarët e grupit dhe atë origjinal. Ndërsa interepretimi i KRPP sqaron "ndërsa se cila dokumente mund të kërkohen e cilat jo nga AK, sipas nenit 72, janë të specifikuara në rregullat dhe UOPP, dhe atë faqe 80, 81, /82 të këtij udhëzuesi". Po ashtu në nenin 72.3 shpjegohet qartë se "sigurimi informacionit që mungon ose ofrimi informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive". Po ashtu të njëjtën neni 39.3 sqaron të njëjtën gjë. Këto janë arsyet për pjesën që nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues. Po ashtu sa i përket mos lejimit për qasje në dokumente në kundërshtim me nenin 10 të LPPP i propozoj panelit të ushtroj autoritetin ligjorë me qëllim të mos lejimit të sjelljeve të tilla nga AK-të".

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK – "KK – Pejë" ka deklaruar: "Ne si AK qëndrojmë në tërësi pranë kundërshtimit që kemi dorëzuar me 06.04.2017 si përgjigje në raportin e ekspertizës, ku kemi detalizuar gjërat në mënyrë shumë precize. Arsyeja e kundërshtimit tonë është sepse nuk shohim kurrfarë arsyeshmërie logjike që një aktivitet të propozohet për rivlerësim vetëm për arsye se nuk paska pas qasje në dokumente OE ankues. Edhe kjo gjë nuk qëndron pasi që për këtë aktivitet OE ankues ka pas qasje në dokumente me datë 22.12.2016, në dosje dhe gjithë dokumentacionin e gjithë pjesëmarrësve në këtë aktiviet. Njëherit i është dhënë nga një kopje fizike këtij dokumentacioni. OE i rekomanduar për kontratë nga AK, edhe në vendimin e panelit nr.06/17 i datës 16.02.2017, nuk është konsideruar si i papërgjegjshëm, por është dhënë sugjerim për AK-në që të përdor nenin 72 të LPP-së. OE i rekomanduar për kontratë është kërkuar ti kërkohen disa sqarime që lënda të kompletohet. Gjatë rivlerësimit AK ka vepruar sipas këtij vendimi dhe sqarimet e dhëna nga OE kanë qenë të mjaftueshme, që komisionin vlerësues ta bindë që këtë OE ta rekomandoj prapë për kontratë. Këtë e ka vërtetuar edhe eksperti në ekspertizën nr.80/17, të datës 05.04.2017, ku të gjitha pretendimet ankimore të OE ankues janë trajtuar si të pabaza. AK pas këtyre sqarimeve ka pa të arsyeshme se çdo gjë ka qenë e sqaruara dhe argumentuar dhe nuk është mbet asgjë kontestuese për këtë aktivet të prokurimit. Për OE ankues nuk kemi pas asgjë të re që ti ofrojmë qasje tjetër pasi ky OE ka pas qasje në dosjet e tenderëve të gjithë pjesëmarrësve me datën e lartpërmendur. Gjithashtu me datë 02.03.2017 OE a ankues është njoftuar me letër standarde për tenderues të pasuksesshëm, dhe në këtë letër i janë shpjeguar veprimet e Ak-së për këtë aktivitet të prokurimit. Kështu pra OE i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar të gjitha kriteret e AK-së dhe i cili ka ofruar edhe çmimin më të lirë për 5500€ më të ulët se OE ankues, dhe këtu AK ka respektuar nenin 60 par.1.1 sipas cilit është edhe publikuar tenderi për OE të përgjegjshëm me çmim më të lirë".

Gjatë prezantimit në seancë ekspertja shqyrtuese ka deklaruar: "Sa i përket nenit 10 të LPP-së pretendim i OE ankues, OE ka bërë kërkesë me datë 06.03.2017, përmes shkresës elektronike tek AK për qasje në dokumente të ofertuesve dhe raport të komisionit Rivlerësues. Në shkresat e lëndës të AK-së nuk kam hasur se AK i ka dhënë qasje OE ankues ashtu siç kërkohet me nenin 10

par.3 të LPP-së. Çështje tjetër është çështja plotësimit të deklaratës së konsorciumit për caktimin e liderit. AK konform nenit 72 të LPP-së ka kërkuar nga OE i rekomanduar për kontratë që të caktoj liderin e grupit përmes vendimit, në këtë rast është caktuar lider OE Dorearti. Çështje tjetër lista shërbimeve, e cila është jo origjinal e dorëzuar nga OE me rastin e ofertimit, AK përsëri ka kërkuar sqarim nga OE në harmoni me nenin 72 të LPP ku është dorëzuar lista projekteve nga OE Dorearti si dhe nga OE Granitit shpk. Me rastin e ofertimit ky OE ka ofrua kontratën me MI si dhe referencën për aktivitetin MI13041/2013. Në rastin konkret me që kanë qenë këto dokumente para datës së afatit të ofertimit, mendoj se AK në rastin konkret ka vepruar konform nenit 72 të LPP. Çështja e pajisjeve që konteston OE ankues, në rastin konkret lista ka ekzistuar mirëpo nuk është specifikuar loti për cilin oferton OE. Me rastin e rivlerësimit, pas kërkesës për sqarime nga AK sipas nenit 72 OE ka ofruar listën ku ka specifikuar edhe lotin për cilin oferton. Me qenë se OE ankues nuk i është lejuar qasje në raport të komisionit, sigurisht ka ndikuar që edhe ankesa të bëhet më mirë, andaj i propozoj panelit që ankesa të aprovohet pjesërisht dhe lënda të kthehet në Rivlerësim. Në vendimin e mëparshëm AK sipas nenit 72 ka mund të kërkoj sqarime, dhe sipas këtij neni AK ka kërkuar sqarime në këto pika".

Gjatë seancës anëtari i panelit shyrtues z.Paçarizi ka pyetur përfaqësuesin e AK-se a ka pas qasje në dokumente, OE ankues pas kërkesës së tij pas rivlerësimit?.

Në përgjigje përfaqësuesi i AK-së ka deklaruar: JO nuk ka pas qasje pasi nuk ka pas dokumente tjera që ti paraqiten.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues ka deklaruar: "OE i rekomanduar për kontratë, lista për punë të kryera është dorëzuar nga Dorearti mirëpo nuk është ofruar listë nga Graniti. Pastaj është dorëzuar lista pajisjeve e pa nënshkruar e pa vërtetuar. Është dorëzuar raport teknik ku ka mjete nga Dorearti dhe as kjo nuk është në origjinal. Vendimi i panelit 06/17 thotë " duke u bazuar në shkresat e lëndës OE i rekomanduar si dëshmi ka ofruar listën e punëve të kryera, të bashkangjitur me kontrata dhe referenca të vulosura në kopje e jo origjinal, përkitazi me kërkesën 9.2 të FDT, andaj paneli konstaton se AK KK Pejë nuk ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së pasi që ka qenë dashur që konform nenit 72 të kërkoj sqarime shtesë". Tek neni 6, AK nuk ka bërë kërkesë as për çmime ndërsa dallimi mes kontratës ka qenë 15.000€. Qëndrojmë në tërësi pranë pretendimeve ankimore dhe lënda të kthehet në rivlerësim dhe të shpallet i papërgjegjshëm OE i rekomanduar".

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së ka deklaruar: "Ne qëndrojmë pranë vendimit të AK-së dhe i propozojmë panelit shqyrtues që të njëjtin ta vërtetoj si të bazuar. OE i rekomanduar për kontratë asnjëherë as nga AK, as nga OSHP nuk ka qenë i shpallur si OE i papërgjegjshëm andaj edhe i rekomandojmë panelit që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, raportin e ekspertit shqyrtues, përgjigjet e palëve në procedurë vjen në përfundim se autoriteti kontraktues

sipas vendimit të dt:16.02.2017 me nr.06/17 ka kërkuar sqarime shtesë konform nenit 72 të LPP-së nga konsorciumi "NP Dorearti&Nt Lindi Markings" përkitazi me listën e projekteve i cili konsorcium me rastin e ofertimit e ka ofruar një listë të projekteve-shërbimeve të ngjashme. Paneli shqyrtues duke u bazuar në dokumentet e konsorciumit të rekomanduar për kontratë konstaton se ky konsorcium pas kërkesës për sqarime, ka ofruar një listë origjinale të projekteve por e cila është e ndryshme me listën kopje të cilën e ka dorëzuar me rastin e ofertimit. Poashtu kjo listë e dorëzuar pas kërkesës për sqarime shtesë e mban datën 28.02.2017 çka do të thotë se kjo listë është përpiluar dhe krijuar pas datës së hapjes së ofertave, pasi që dihet se hapja e ofertave është bërë me dt:15.12.2016, prandaj ky fakt është në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 72 të LPP-së ku thuhet "*Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive*".

Duke pasur për bazë faktet e cekura më lartë dhe të gjitha dëshmitë e prezantuara nga ekspertja shqyrtuese dhe nga palët në procedurë gjatë seancës dëgjimore, paneli shqyrtues konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së, përkitazi me nenin 69 të këtij Ligji dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe paragrafi 3 i nenit 72 të LPP-së.

Poashtu paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 10 të LPP-së dhe obligon autoritetin kontraktues që në të ardhmen ti respektoj në tërësi dispozitat e LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim IDONA

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT PRISHTINË ZYRA ZËVENDËSUESE E REPUBLIKËS SHQIPËRIA KOSOVA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Komuna e Pejës"

1x1 OE – "ER-LIS Sh.p.k & VE-MOR Sh.p.k" - Pejë

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.